



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPJAN

Pranimë me:	18.01	2024
Numri i:	Numri	Shtojca
Vendi	Seri	Dodatak
Jedhëz		
01-030	24807	



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PLANI VJETOR I PUNËS SË KRYETARIT DHE DREJTORATEVE KOMUNALE

2021

PËRMBAJTJA

DREJTORATET KOMUNALE

1. Drejtorati për Administratë.....	4
2. Drejtorati për Arsim	5
3. Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport	8
4. Drejtorati për Buxhet dhe Financa	10
5. Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim	14
6. Drejtorati i Inspektoriatit	17
7. Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale	19
8. Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	22
9. Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër	24
10. Drejtorati i Shërbimeve Publike	25
11. Drejtorati i Prokurimit.....	28
12. Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari	30
13. Drejtorati për Mbrojtje dhe Shpëtim.....	32

Objektivat strategjike për një qeverisje të mirë për komunën e Lipjanit gjatë vitit 2021 janë:

1. Lipjani, një vend i qetë për të jetuar e punuar ndershëm dhe për të rritur, edukuar fëmijet lirëshëm me motivim për një vend të qetë e prosperues.

2. Administratë digitale me teknologji të avancuar, efikase, transparente, llogaridhënëse, ofrimi i shërbimeve cilësore, e në shërbim të komunitetit.
3. Intensifikimi i angazhimeve për përmirësimin e klimes së të bërit biznes dhe promovimin e Komunës së Lipjanit si një komunë atraktive për investitorët strategjik për të investuar dhe për tu vizituar, të hapur ndaj ideve inovative, të orientuar drejt iniciativave inovative dhe projekteve të reja smart.
4. Të sigurohet një pozitë e qëndrueshme financiare me një menaxhim financiar efektiv dhe transparencë të plotë në menaxhimin e buxhetit komunal. Vazhdim i suksesshëm i realizimit të buxhetit komunal dhe i të hyrave vetanake për vitin 2021.
5. Sigurimi i arsimit sa më cilësor, me personel të kualifikuar dhe të aftësuar në vazhdimësi duke zbatuar teknikat, metodat dhe strategjit bashkëkohore gjatë punës, si dhe investime të vazhdueshme në infrastrukturën shkollore.
6. Ofrimi i shërbimeve cilësore në mjekësinë primare, zhvillimin e vazhdueshëm profesional, programet e ngritjes profesionale dhe specializimet si dhe ngritjen e infrastrukturës si me resurse humane po ashtu edhe me paisje mjekësore dhe infrastrukturë përcjellëse.
7. Vazhdimi i përkrahjes së fermerëve për zhvillimin e bujqësisë dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese, përpunuese si dhe mirëqenia ekonomike e fermerëve përmes subvencioneve dhe shërbimeve këshillimore.
8. Bibliotekë digitale, investime dhe mirëmbajtje të objekteve sportive dhe të ambienteve për rekreacion, vazhdim i subvencionimit të klubeve sportive si dhe subvencionimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe rinore.
9. Ofrimi i shërbimeve profesionale dhe efektive sipas kërkesave të qytetarëve dhe në harmoni me rregullativen ligjore nga fusha e planifikimit dhe ndërtimit dhe senzibilizimi i qytetarëve në mbrojtjen e mjedisit.
10. Mirëmbajtja e lapidarëve dhe varrezave, parqeve, hapësirave gjelbra, shtigjeve të ecjes dhe bicikletave, mbjellja e pemëve si dhe vazhdimi i mirëmbajtjes dhe ndërtimit të shtretëve të lumenjëve.
11. Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës tjetër publike me standarde të larta në shërbim të të gjithë qytetarëve.

12. Bashkëpunim të vazhdueshëm me kompanitë publike për shtimin e kapaciteteve për ujë të pijes dhe për shërbime më efektive në grumbullimin e mbeturinave për një ambient më të pastër.

13. Bashpunimi me komunitete fetare, shoqëritë civile, OJQ ndërkombëtare, vendore dhe partner të tjerë.

DREJTORATI PËR ADMINISTRATË

Plani vjetor i punës do të bazohet në prioritetet e të cilat do të paraqesin si objektiva, si dhe në punët e përditëshme, gjithëashtu si matës të këtij plani do të paraqesin në shtyllën e dytë aktivitetin, ku të cilin planifikojmë të arrijmë. Të vendosur dhe me përkushtimin më të madh në implementim, këtë plan do të paraqesin në dy shtylla, në shtyllën e parë janë objektivat, në shtyllën e dytë aktivitetet.

Objektivat	Aktivitetet
Objektivi ynë i parë do të mbetet efikasiteti i punës në administratë, Objektivi ynë i dytë do të jetë ofrimi i shërbimeve cilësore, Objektivi i tretë Administratë digjitale me teknologji të avancuar, Objektivi i katërt transparenca dhe llogaridhënia, Objektivi i Pestë është minimizimi i shpenzimeve, Objektivi i gjashtë ngritja e kapaciteteve humane dhe teknologjike, Objektivi i shtatë mbrojtja e pa kompromis e të drejtave të qytetarëve,	Me qëllim të ngritjes së efikasitetit sa më të lartë në punë ne do të shtojmë përkushtimin tonë duke filluar nga Drejtori i Drejtoratit. Ky objektivi është i matshëm në komunën tonë, tani mirëpo këtu ka vend për përmirësim në sektorët e caktuar duke u ofruar shërbime më cilësore dhe më kualitative të gjithë qytetarëve pa dallim. Digjitalizimi dhe teknologjia e avancuar e administratës do të ndihmojë me shumë kualitetin e shërbimeve. Administrata Digjitale është një proces i gjatë i cili do të përcillet në kohë edhe nga komuna jonë. Transparenca dhe llogaridhënia do të ngrisim duke shfrytëzuar kapacitetet që kemi, si dhe duke ia shtuar kapacitetet tjera goftë humane apo shfrytëzimin e teknologjisë. Se minimizimi i shpenzimeve të pa nevojshme do të ndodhë dhe ky shkurtime do ta ndjek në vazhdimësi trendin me tendencë përmirësimi. Dhe kjo do të arrihet përmes shfrytëzimit të IT-së më tepër si dhe një mbikqyrje e vazhdueshme për të. Ngritja e kapaciteteve humane do të arrihet brenda vitit 2021 duke trainuar stafin aktual si dhe duke ndërruar paisjet e vjetruara të IT.

Objektini i tetë do të jetë krijimi i kushteve sa më të mira për punëtorët e këtij drejtorati, Objekti i nëntë do të jetë ndarja srike e detryave dhe përgjegjive tek zyrtarët e sektorve përkatës, Objekti i dhjetë është rritja e llogaridhënies nga zyrtarët për përgjegjësitë e tyre, Bartja e Administratës nga objekti aktual në objektin e ri, Objekti i njëmbëdhjetë përkushtimi ndaj qytetarëve dhe mbrojtja e vlerave të institucionit. Objekti i dymbëdhjetë ngritja në vazhdimësi e përgjegjësisë dhe llogaridhënies lidhur me shfrytëzimin e resurseve gjegjësisht veturave të komunës, Objekti i trembëdhjetë por jo më pak i rëndësishëm ai i sektorit të kuvendit ku parashohim ngritjen e kualitetit s më të lartë për kryerjen e punëve teknike që kanë të bëjnë me Kuvendin dhe trupat e tij.	Bartja e Administratës në objektin e ri. Shtimi i kapaciteteve shtesë të teknologjisë dhe nevojave tjera për Administratën në objektin e ri. Mbrojtja e pa kompromis e të drejtave të qytetarëve do të bëhet në atë mënyrë që të gjitha vërejtjet, sugjerimet, ankesat dhe kërkesat e ndyshme të qytetarëve do të shqyrtohen me përkushtimin më të madh. Do të krijojmë kushte sa më të mira për të gjithë puntorët brenda kapaciteteve eksistuese. Rritja e llogaridhënies do të shtohet në atë formë që zyrtarët do të këshillohen që për çdo shërbim ta dorëzojnë një raport mujor.
---	---

DREJTORATI PËR ARSIM

Si prioritet i Drejtoratit Komunal të Arsimit është siguri i arsimimit sa më cilësor, me personel të kualifikuar dhe të aftësuar në vazhdimësi duke zbatuar teknika, metoda dhe strategitë bashkë kohore gjatë punës.

Planifikohet që të vazhdojmë procesin e zbatimit të zbatimit të kurrikulës së re në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, në kuadër të programeve trajnuese për shkolla rreth strategjisë për sigurimin e cilësisë në Arsimin Parauniversitar në Kosovë.

1. Objektivat e përgjithshme

Gjatë vitit 2021, angazhimet e DKA-së do të vazhdojnë të fokusohen në:

Mbikëqyrja e institucioneve arsimore dhe vlerësimi i performancës së të gjithë të punësuarve të drejtorisë dhe drejtuesve të institucioneve arsimore në nivel komunal;

Regjistrimi i të gjitha të dhënave të nxënësve dhe evidentimi, ruajtja dhe arkivimi i dosjeve të personelit arsimor dhe trupi menaxherial;

Nxirja dhe promovimi i mundësisë për të ndjekur arsimin përparshkollor, arsimin e obliguar fillor dhe atë të mesëm në kushte të barazisë së plotë për të gjithë;

Identifikimi dhe konstatimi i nevojave për ngritje të vazhdueshme profesionale të drejtorëve dhe të personelit arsimor aktiv, në pajtim me dispozitat e ligjeve në fuqi;

Organizimi i trajnimeve për mësimdhënësit dhe stafin tjetër profesional;

Hartimi, propozimi dhe miratimi i rregullorevë të punës për shkolla të të gjitha niveleve në kompetencë të Komunës, duke përfshirë Kodin e mirësjelljes për stafin udhëheqës, mësimdhënësit nxënës dhe personelin tjetër mbështetës; Monitorimi dhe mbikëqyrja e vendimeve të drejtorëve të shkollave të të gjitha niveleve;

Monitorimi i të gjitha të hyrave dhe shpenzimet e Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Lipjanit si organizatë buxhetore; Nxirja e bashkëpunimit në mes mësimdhënësve prindërvë, nxënësve, me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësim-nxënies në shkolla;

Organizimi i garave të ndryshme të diturisë në mes të shkollave, nga lëndët matematikës dhe shkencave natyrore dhe ndanë shpërblime dhe mirënjohje për nxënësit dhe punëtorët arsimor të merituar;

Kujdesi për mirëmbajtjen e ambienteve rrethuese të shkollave duke promovuar gjelbërimin e tyre;

Bashkëpunimi me OJQ dhe shoqëri të civilë si dhe me organizata qeveritare dhe joqeveritare me qëllim të tërheqjes së donacioneve në interes të shkollave publike të të gjitha niveleve para-universitare dhe me qëllim të avancimit dhe ngritjes së kualitetit të mësimdhënies dhe mësim-nxënies;

Për arrijtjen e objektivave të shëndetit publik ndërmarrim aktivitete dhe zhvillojm programet të përbashkëta me MASHT dhe shkollat për të nxitur kujdesin shëndetësor dhe shmagur smundjet ngjitëse dhe dukuritë devejante;

Kujdeset dhe mbështet arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta (speciale), në përputhje me masën dhe nevojat specifike të tyre si dhe ëdo nxënësi pa asnjë dallim t'i sigurohen kushtet e nevojshme për nxënie cilësore të diturisë; Programet në shkolla fillore dhe të mesme në bashkëpunim me MASHT-in të sigurojnë përgatitjen e nxënësve që të mendojnë dhe punojnë në mënyrë kreative dhe ambicioze në zgjidhjen e të gjitha problemeve. Të zhvillojnë shkathësitë e nevojshme dhe shprehjet e punës për t'iu përgjigjur me sukses sfidave të jetës së përditshme, shkollimit të mëtejme në përvetësimin e përhershëm të mësimit me moton "Mësimi gjatë gjithë jetës"; Shkollat të jenë të hapura, ku prindërit do të kenë mundësi të kycjes në vendimet të cilat kanë të bëjnë me fëmijët e tyre;

Arritjen e objektivave të shëndetit publik ku DKA në bashkëpunim me DSH nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme do të ndikojnë në nxitjen e shtimit të shëndetit për të shmangur përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, si dhe aksione kundër duhanit dhe formave të abuzimit me drogë.

Organizimin i mësimit në kushte të pandemisë duke respektuar masat kundër shpërndarjes së virusit COVID 19.

II Objektivat prioritarë për vitin 2021

Për periudhën njëvjeçare Drejtoria e Arsimit në Lipjan synon arritjen e prioriteteve si:

Funksionalizimi i kabineteve të TIK-ut në shumicën e shkollave të Komunës;

Zgjerimi i kapaciteteve të qerdhës publike për pranimin e fëmijëve të moshës 1-5;

Sigurimi i kabineteve të shkencave të natyrës për disa shkolla fillore dhe të mesme;

Fuqizimi i të gjitha organeve profesionale të shkollave si këshillat e prindërve & këshillat drejtuese si dhe inkurajimi i prindërve dhe i shoqërisë së gjerë në mbështetjen e arsimit dhe arsimimit të përgjithshëm;

Zbatimi i programeve të veçanta kundër braktisjes së shkollës;

Nxjerja e rregulloreve, mbikëqyrja dhe zbatimi i tyre si dhe Informimi i Kuvendit Komunal për rezultatet, vështirësitë dhe rrjedhën e procesit edukativo-arsimor në tërësi në komunën tonë;

Angazhimi në sisteminin e nxënësve me nevoja të veçanta nëpër klasa të bashkangjitura si dhe sigurimi i mësuesve mbështetës për ta;

Ngritja e përqindjes së aritshmërisë dhe kalueshmërisë në vlerësimet e jashtme;

Organizimi i mësimi shtesë për lëndët prioritare si dhe zvogëlimi i numrit të nxënësve në klasat e mbingarkuara.

III. Monitorimi dhe aktivitete bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë:

Qëllimi i përgjithshëm i monitorimit është që të shtohet cilësia e planifikimit, programimit dhe efikasitetit të punës së institucioneve edukativo-arsimore në nivel komunal.

Giatë vitit 2021 në të gjitha-institucionet edukativo-arsimore të komunës sonë, në të gjitha shkollat fillore amë dhe paralelet e ndara, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, si dhe institucionet parashkollore planifikojmë të realizojmë vizita monitoruese të shpeshta shkollore. Pra, nëpërmjet kontrollimeve të vazhdueshme, anketimeve, pyetësorëve, bashkëbisedimeve dhe shumë instrumenteve tjerë do të realizohet mbikëqyrja për së afërmi e rrjedhës së punës në shkolla. Në këtë drejtim për ta përmbushur këtë qëllim ne do të bashkëpunojmë edhe me Zyrën Rajonale të Inspeksionit (ZRI). Drejtorja duke u bazuar në strukturën e organizimit dhe funksionimit, në kuadër të kompetencave, autorizimeve dhe përgjegjësiive ligjore, udhëzimeve administrative të MASH-it dhe Statutit të Komunës, punën e vet kryesisht do ta orientojë në:

Udhëheqjen dhe menaxhimin e çdo institucioni edukativo-arsimor publik para-universitar në përputhje me ligjet në fuqi dhe strategjinë e MASH-it dhe Komunës;

Në krijimin dhe mbikëqyrjen e kushteve normale për punë të institucioneve edukativo-arsimore në tri nivele: 0-1, 2 dhe 3; Mbikëqyrjen e realizimit të plan-programeve globale mësimore dhe atyre konkrete të mësimdhënësve në institucionet edukativo-arsimore në të tri nivelet;

Mbikëqyrjen e realizimit të plan-programeve vjetore të shkollave;

Përcjelljen dhe mbikëqyrjen e funksionimit të organeve udhëheqëse dhe profesionale të shkollave;

Përcjelljen dhe krijimin e kushteve normale për punë të nxënësve me nevoja të veçanta (që kanë pengesa në të folur, dëgjim, pamje etj);

Mbështetjen dhe krijimin e kushteve për punë shitesë të nxënësve me talent të veçantë dhe avancimin e tyre;

DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Prioritetet:

Ligjërata, tryeza, konferenca me OJQ-të rinore dhe KVRL-në. Takime për kordinim sa më të mirë të mundshëm për aktivitetet kulturore, sportive dhe rinore.

Hartimin e rregullorës për punën vullnetare.

Riorganizimi i Ansambllit të këngëve dhe valleve SH.K.A "Ulpiana"

Krijimi i një muzeu për Lipjanin. Përmes një thirrje publike do të kerkohen eksponante të cilat do t'i dorëzojnë veprat e ndryshme në drejtoratin për kulturë, rini dhe sport, dhe një vend do të caktohet si muze.

Formimi i një Kori të Qytetit. Nga mësimdhënsit e muzikës Lipjan do të kërkohet formimi i një grupi apo kori të qytetit në bashkëpunim me DKRS-n.

Ndarja e një çmimi për lexuesin më të mirë. Ndarja e këtij çmimi mendohet të bëhet në muajin Shtator pasi që me 8 Shtator të po këtij muaji është dita ndërkombëtare e leximit, ky çmim do të ndahet me një vendim të kryetarit i cili vendim do të nxirret pas propozimit nga DKRS-ja.

KULTURA

Mbajta e dy orëve letrare për data të caktuara 7 mars Dita e Mësuesit dhe 12 qershor dita e çlirimit të Komunes se Lipjanit

Akademi përkujtimore për nder të 15 prillit Ditës së 155 të Martirëve të Komunës së Lipjanit.
Ditët e Kulturës 6-14 Qershor

Manifestimi për Ditën e Çlirimit të Lipjanit 12 qershor
Manifestimi për Ditën e Dëshmorve 14 Qershor

Manifestimi tashmë Tradicional Ditët e Diasporës „Mir se erdhët Bashkëatdhetar në Vendlindjen Tuaj”
Realizimi i Festivalit për Fëmijë „LIPJANI KENDON”

Organizimi i konkursit letrar për poezi dhe prozë,
Pjesëmarrja e grupit të fëmijëve të instrumentalistve të vegjël popullore në festivalin mbarekombëtar i cili mbahet në Fushë-Arrëz Republika e Shqipërisë, Maj 2021,
Manifestimi kulturo-shkencor “Gjurmë të Gjeqovit”.

Organizimi programeve kulturore me rastin e festave të nentorit
Dekorimi i sheshit “Adem Jashari” dhe qytetit.

SEKTORI PËR RINI DHE SPORT

Organizimi i Debateve, Tryezav, Ligjeratave me të rinjtë.

Organizimi i aksioneve të ndryshme rinore për mbrojtjen e ambientit.

Organizimi i trajnimeve me të rinjtë.

Identifikimi i talentëve të rinj të sportit.

Turniri tradicional, në futboll të vogël „Kupa e Pavarësisë”, me rastin e 17 Shkurtit.
Ligjerata, tryeza , konferenca me OJQ-të rinore dhe KVR-L-në.

Aktivitetet e ndryeshme me rastin e 12 gushtit, ditës së rinisë.
Takime të rregullta me shoqërinë civile.

Organizimi i aktiviteteve rekreative-sportive me fëmijë dhe të rinjë.
Përgatitja e shpalljeve publike për subvencionim të klubeve sportive dhe OJQ-ve.
Zgjedhja e sportistit të vitit.

BIBLIOTEKA

Paisja e Bibliotekës Amë dhe degëve të saja, literaturë (titujve të rinjë).
Lektymimi i skedarit, sistemimi i skedarit në katalogun qendëror.

Përpunimi fizikë të librit.

Digjitalizimi i bibliotekës së Qytetit.

SEKTORI I ARKIVIT

Ngritja e efikasitetit dhe menaxhimit për ofrimin e shërbimeve për qytetarë.

Grupullimi i materialit, nga regjistratat e mbetura pa përkujdesjen e pronarve.

Evidentimi i regjistraturave, si krijues të lëndëve arkivore dhe personave privat, si posedues të dokumentacionit të shkruar.

Digjitalizimi i Arkivës së qytetit.

DREJTORATI PËR BUXHET DHE FINANCA

Objektivat e përgjithshme:

Të sigurohet një pozitë e qëndrueshme financiare e Komunës së Lipjanit.

Të sigurohet një planifikim fiskal dhe financiar, të ofrohen këshilla dhe analiza dhe koordinim në mbështetje të politikës së Komunës dhe në mbështetje të një vendimmarrjeje të informuar.

Të zhvillohet dhe të administrohet një menaxhim financiar efektiv, përmes të cilit drejtoratet dhe të gjithë zyrtarët autorizues të kenë mundësinë të administrojnë buxhetet e tyre siq duhet dhe me përgjegjësi.

Vazhdimi i menaxhimit transparent të buxhetit komunal. Në web faqen e Komunës të publikohen të gjitha raportet nga drejtorati për Buxhet dhe Financa si dhe subvencionet.

Realizimi i të hyrave vetanake në vlerë 1,907,316.00 € në vitin 2021. Vazhdimi i rritjes së inkasmit të tatimit në pronë duke vazhduar me qasjen "zero tolerancë ndaj mospagesës së tatimit në pronë" dhe "qasjes së njëjtë për të gjithë". Të sigurohet rianketimi i 1/3 së pronave. Të vazhdohet me kontaktimin e borxhëinjëve, procedimin e vërejtjeve dhe bllokimin e llogarive bankare duke respektuar procedurat dhe afatet ligjore. Të vazhdohet me rritjen e të hyrave nga lejet ndërtimore.

Vazhdimi i shlyerjes së obligimeve kontraktuale dhe financiare të gjeneruara në vitet paraprake, dhe planifikimi i shlyerjes së këtyre obligimeve në vitin e ardhshëm buxhetor përmes rritjes së të hyrave.

Regjistrimi i të gjitha pasurive komunale dhe pasurive në vijim.

Objektivat specifike:

Të sigurohet një pozitë e qëndrueshme financiare e Komunës së Lipjanit.

Të sigurohet disponueshmëria dhe zotimi i mjeteve para qdo hyrje në marrëdhënie kontraktuale. Gjatë vitit fiskal 2021, të sigurohet planifikimi i buxhetit për qdo shpenzim në të gjitha kategoritë ekonomike.

Të sigurohet një planifikim fiskal dhe financiar i shëndoshë, kështu, analiza dhe koordinimin në mbështetje të

politikës së Komunës dhe në mbështetje të një vendimmarrje të informuar.

Të sigurohet planifikimi i buxhetit me pjesëmarrje.

Të organizohen degjime buxhetore si nga Ekzekutivi ashtu edhe nga Legjislativi.

Ekzekutivi të organizojë degjime buxhetore për KAB pas pranimit të Qarkores buxhetore 2021/1 deri më 30.06.2021.

Nga 01.06.2021 deri më 29.06.2021 Kryetari i Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Fianca të organizojnë degjime buxhetore për Kornizen Afatmensme Buxhetore 2022-2024.

Nga 01.07.2021 deri më 30.08.2021 Kryetari i Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Fianca të organizojnë degjime buxhetore për Planifikim të Buxhetit 2022-2024.

Dorëzimi me kohë i projekt buxhetit të Komiteteti për Politikë dhe Financa dhe komitetet tjera relevante.

Dorëzimi me kohë i Propozimit për Planifikim të Buxhetit, jo më larg se 01.09.2021, në Kuvend dhe ofimi i kohës së nevojshme për asambleistë të Asamblesë Komunale për të analizuar dhe kontribuar në planifikim buxhetor.

Nga 01.09.2021 deri më 30.09.2021 Asambleja Komunale të organizoj së paku 2 degjime buxhetore për Planifikim të Buxhetit.

Të përfshihen në degjime buxhetore së paku 50 grupe të interesit, duke përfshirë lokalitetet, shoqërinë civile, personat me aftësi të kufizuara, komunitetet pakicë dhe grupet tjera të interesit.

Të planifikohet një buxhet me perspektivë gjinore.

Mbështetja e vendimmarrjes përmes raportimit të rregullt dhe me kohë
Të raportohet në baza javore në bordin e drejtorëve : realizimin e buxhetit, realizimin e investimeve kapitale dhe realizimin e të hyrave vetanake.

Raportimi përmes raporteve javore, mujore dhe vjetore për zyrën e Kryetarit.

Te raportohet para Asamblesë Komunale mbi shpenzimin e buxhetit, realizimin e të hyrave vetanake, realizimin e investimeve kapitale në baza periodike 3 mujore dhe vjetore.

Raportimi vjetor duhet të bëhet jo më vonë se 31 Mars 2021.

ZKF të raportoj në baza të rregullta për Ministrin e Financave dhe ZKA-në për realizimin e Investimeve Kapitale.

ZKF të raportoj, në baza të rregullta, për obligimet financiare për Zyrën e Kryetarit dhe Ministrinë e Financave.

Të informohet Asambleja Komunale mbi Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Të zhvillohet edhe më tutje dhe të administrohet një menaxhim financiar efektiv përmes të cilit drejtoratet, dhe të gjithë zyrtarët autorizues të kenë mundësinë të administrojnë buxhetet e tyre siq duhet dhe me përgjegjësi
Buxheti i planifikuar nëpër të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzohet sipas planifikimit. Buxheti i planifikuar në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime të shpenzohet sipas planifikimit. Në rast të nevojave për të ndryshuar destinacionin e shpenzimit, shpenzimi ndryshe prej planifikimit të bëhet vetëm mbas rishikimit të buxhetit ose ridesinimeve buxhetore.

Zotimi i mjeteve për kontratat kornizë të bëhet para arritjes së faturës për pagesë. Zotimi do të bëhet në përputhje me planin e rrjedhës së parase, në baza tremujore.

Vazhdimi i menaxhimit transparent i buxhetit komunal

Sigurimi i plotë i transparencës komunale duke publikuar në webfaqe të Komunës:
Buxhetin Komunal për vitet 2022/2024 si dhe Planifikimin e Buxhetit, mbas aprovimit, për vitet 2022/2024 jo më larg se 15 ditë nga data e aprovimit nga Parlamenti i Republikës së Kosovës.

Raportet periodike dhe vjetore të shpenzimit të buxhetit, jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga Raportimi në Asamblenë Komunale

Publikimi i raporteve periodike dhe vjetore të akkëtimit të hyrave, jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga Raportimi në Asamblenë Komunale

Publikimi i raporteve mujore, periodike dhe vjetore.

Publikimi i rregulloreve të brendshme,

Publikimi i vendimeve,

Publikimi i Subvencioneve,

Qasja e lirë në dokumentet publike, brenda afatit, e rregulluar me ligjet në fuqi.

Buxhetimi me pjesëmarrje. Publikimi i thirrjeve për dëgjime buxhetore me kohë në web faqe të Komunës dhe shpërndarja e ftesave në të gjitha lokalitetet e Komunës së Lipjanit, dhe të të gjitha grupet e interesit si: shoqatat e grave, grupet e të rinjve, shoqatat dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuara, OJQ, etj.

Publikimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2022-2024.

Publikimi i Planifikimit të Buxhetit për vitet 2022-2024.

Publikimi i inkasimit të të hyrave vetanake.

Publikimi i Pasqyrave Financiare.

Publikimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm.

Publikimi i dokumenteve tjera financiare të cilat janë të klasifikuara si dokumente publike.

Realizimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2021

Realizimi i të hyrave vetanake të Planifikuara në vlerë prej 1,907,316.00€

Realizimi i tavanit të të hyrave vetanake duke u bazuar në avancimin e mëtutjeshëm të kontrollës së brendshme financiare.

Realizimi i të hyrave vetanake duke avancuar komunikimin me qytetarë rreth dobisë për qytetarët nga pagesa e rregullt e tatimeve dhe taksave komunale.

Realizimi i të hyrave vetanake nga Tatimi në Pronë. Vazhdim i rritjes së inkasimit të tatimit në pronë duke vazhduar me qasjen "zero tolerancë ndaj mospagesës së tatimit në pronë" dhe qasjes "njëjtë për të gjithë". Të vazhdohet me kontaktimin e borxhlinjve, procedimin e vërejtjeve dhe bllokimin e llogarive bankare mbas përfundimit të afatit për falje të borxheve. Të sigurohet rianketimi i 1/3 së pronave.

Realizimi i të hyrave vetanake nga rritja e të hyrave nga Shfrytëzimi i Hapesirave Publike. Realizimi 100% i planifikimit për këtë burim të të hyrave.

Realizimi i e të hyrave vetanake nga rritja e të hyrave nga qeraja.

Realizimi i e të hyrave vetanake nga rritja e të hyrave nga lejet e ndertimit.

Realizimi i të hyrave vetanake duke i kthyer këto të hyra në formë të investimit të ato lokalitete të cilat kanë paguar përqindje më të madhe të tatimeve dhe taksave komunale.

Realizimi i të hyrave duke identifikuar dhe anketuar objektet e reja ose të paanketuara dhe faturim i tyre për tatim në pronë.

Realizimi i të hyrave nga identifikimi i mënyrave të reja të financimit të buxhetit komunal nga të hyrat vetanake.

Shpenzimi i Buxhetit në harmoni me Ligjin mbi Financat Publike dhe Përgjegjësitë dhe avancimi i mëturjeshtëm i kontrollës së brendshme financiare

Avasimi i mëturjeshtëm i kontrollës së brendshme financiare dhe dinamikës së shpenzimeve përmes futjes së të dhënave në programin për menaxhimin financiar.

Avancimi i mëturjeshtëm i planit dinamikë të shpenzimit të buxhetit duke përgatitur raporte rreth dinamikës së realizimit të shpenzimeve. Raportimi i rregullt mbi realizimin e Investimeve Kapitale.

Informimi me kohë i drejtorateve komunale dhe zyrës së Kryetarit për alokimet e mjeteve. Përcjellja e zotimit dhe shpenzimit të mjeteve për shpenzimet e planifikuara, dhe informimi me kohë për drejtoratet respektive rreth gjendjes aktuale.

Shpenzimi i mjeteve në përputhje me planifikimet buxhetore për të gjitha kategoritë si: Paga dhe Meditje, Investimeve Kapitale, Mallra dhe Shërbime, Subvencione e Transfere, dhe Komunalit.

Përmirësimi i mëturjeshtëm i shpenzimit proporcional të buxhetit, duke avancuar më tutje bashkëpunimin në mes të Drejtoratit për Buxhet dhe Financa, Drejtoratit për Planifikim dhe Urbanizëm, Drejtoratit të Shërbimeve Publike dhe Drejtoratit të Përkurimit. Harmonizimi i shpenzimit të buxhetit me planin e prokurimit dhe rjedhën e parësë.

Dhënia e disponueshmërisë së mjeteve për investime kapitale, vetëm atëherë kur është planifikuar shpenzimi dhe kur ka disponueshmëri të fondeve.

Avancimi i mëturjeshtëm i pagesës së faturave brenda afatit ligjorë, si dhe evitimi i mundësisë së shëndrimit të këtyre faturave në obligime financiare.

Regjistrimi i Pasurisë kapitale Komunale, në SIMFK, E-pasuri dhe Exsel.

Regjistrimi i pasurisë nga Investimet Kapitale të ndodhura në këtë vit buxhetor.

Regjistrimi i pasurisë komunale në vijim, për investimet e pakryera.

Regjistrimi i pasurisë komunale nga palët e treta.

DREJTORATI PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM

QËLLIMI

Gjatë këtij viti, qëllim i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim është intensifikimi i angazhimeve për përmirësimin e klimës së të bërit biznes dhe promovimin e Komunës së Lipjanit si një komunë atraktive për investitorët strategjik për të investuar dhe për tu vizituar, të hapur ndaj ideve inovative, të orientuar drejt iniciativave inovative dhe projekteve të reja smart.

AKTIVITETET

Vazhdimi i angazhimeve rreth gjetjes së burimeve të financimit për ndërtimin e Zonës Ekonomike "Parku Industrial në Qylagë"

Bashkëpunim i ngushtë me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë rreth financimit të ndërtimit të Zonës Ekonomike. Vazhdimi i punimeve në zonën ekonomike në Qylagë.

Zhvillimi i dokumenteve dhe materialeve të marketinkut me qëllim të tërheqjes së investitorëve të jashtëm dhe vendor si dhe tërheqjen e turistëve në destinacionet turistike të Komunës së Lipjanit

Zhvillimi i ofertës investive: Me qëllim të fuqizimit të zhvillimit ekonomik përmes tërheqjes së investitorëve të jashtëm dhe investitorëve vendor, Drejtoriati për Ekonomi dhe Zhvillim do të hartoj një ofertë investive e cila ka për qëllim të informoj investitorët potencial rreth përparësive konkurruese që ofron Komuna e Lipjanit për të bërë biznes, mundësi dhe ambientit të butë biznesor, procedurave administrative të thjeshtëzuara dhe efektive, pozitës së favorshme gjeografike, pasurive natyrore si dhe fuqisë punëtore të re, të edukuar dhe të lirë.

Bashkëpunimi me ASB dhe PREDA Plus, gjithashtu vazhdimi i angazhimit tonë së bashku me UNDP-në, dhe BEE.

Thirrje për biznese start-up.

Mbështetje e ideve, iniciativave dhe projekteve inovative të të rinjëve dhe gruas

Nënshtkrimi i memorandum bashkëpunimi me UNDP-ne për restaurimin e qytezës së Janjevës.

Rritja e zhvillimit ekonomik në Komunën e Lipjanit përmes rishikimit dhe lehtësimit të procedurave administrative me theks të vegantë procedurat e dhënjes së lejeve dhe pëlqimeve

Lehtësimi i procedurave administrative do të shërbej si mjet kryesor për tërheqjen e investitorëve. Do të angazhohemi që "Projektin për Lehtësimin e Procedurave Administrative" ta finalizojmë në bashkëpunim të ngushtë me Bankën Botërore. Rritja e bashkëpunimit institucional në mes të Komunës së Lipjanit dhe sektorit privat dhe përfshirja e tij në vendimmarrje Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim synon që brenda këtij viti të avancoj bashkëpunimin me Sektorin Privat duke organizuar, por jo duke u limituar, takime me përfaqësuesit e bizneseve dhe të diskutoj për sfida, pengesat, mundësitë dhe planet zhvillimore, takimet vjetore, tryezat informuese.

Gjatë këtij viti, synojmë të i vizitojmë disa nga bizneset dhe të diskutojmë për së afërmi nevojat dhe mundësitë e këtyre bizneseve.

Biznesi privat do të kyqet drejtëpërdrejtë në marrjen e vendimeve dhe aprovimin e dokumenteve strategjike të cilat kanë ndikim në zhvillim ekonomik.

Bashkëpunim i ngushtë me nivelin qendror

Angazhimi i përbashkët me ministritë relevante rreth gjatës së mundësive për përkrahjen e projekteve kapitale me qëllim të rrijës së konkurrshmërisë së Komunës së Lipjanit për zhvillim ekonomik.

Sigurimi i përkrahjes dhe bashkëpunimit nga ministritë relevante rreth hartimit të dokumenteve strategjike dhe operacionale.

Bashkëpunim i ngushtë me ministritë relevante rreth promovimit të zhvillimit ekonomik në Komunën e Lipjanit.

Sigurimi i përkrahjes nga ministritë relevante rreth ndërtimit dhe avancimit të raporteve me organizatat vendore dhe ndërkombëtare të cilat mund të ndikojnë në zhvillim ekonomik lokal.

Mobilizimi i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim për të hulumtuar dhe përcjellur thirrjet për donacione, grante dhe burime tjera të finacimit dhe informimi me kohë i sektorit privat, OSHC-ve, dhe aktërëve tjerë relevant

Hulumtim i rregullt në baza ditore për grante, donacione dhe burime tjera të financimit.

Informimi i menjëhershëm i Sektorit Privat dhe aktërëve tjerë për thirrjet për grante dhe donacione.

Organizimi i tryezave informuese.

Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim do të menaxhoj hartimin e aplikacioneve për projektet që dorëzohen te donatorët. Nxitja e zhvillimit ekonomik përmes promovimit të inovacioneve.

Hulumtimi për qasje në burime të financimit për ide dhe projekte inovative.

Monitorimi i Memorandumit i Bashkëpunimit me organizatën Women4Women

Realizimi i trajnimeve për gratë e marginalizuara, mundësitë e përmirësuar të vetë-punësimit dhe punësimit. Mbatja e panairit së bashku me KW4W.

Monitorimi i Implementimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2019-2023

Vlerësimi vjetor i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2019-2023.

Raportimi vjetor për Kryetarin e Komunës mbi implementimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2019-2023.

Rishiqimi dhe vlerësimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2019-2023

Edhe pse Strategjia për Zhvillim Ekonomik 2019-2023 është hatruar për 5 vite, në rast të nevojës, si përgjigje ndaj kushteve dinamike lokale, në bashkëpunim me ekzekutivin dhe legjislativin strategjia do të rishikohet.

Publikimi, menaxhimi dhe mbajtja e evidencës për pronën

Monitorimi i të hyrave nga qeraja.

Dorëzimi i raporteve për Sektorin Pronëso-ro-Juridik për vonesat e pagesës së qeras.

Vendosja e një bashkëpunimi të ngushtë me Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, Drejtoratin e Inspeksionit, Sektorin Pronëso-ro-Juridik, Drejtoratin e Shërbimeve Publike dhe drejtoratet tjera relevante

Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim do të asistoj drejtoratet tjera rreth plotësimit të aplikacioneve për dorëzim të donatorët. Drejtorati për Zhvillim dhe Ekonomi do të pranoj projektet ideore nga të gjitha drejtoratet dhe do të shqyrtoj mundësitë e gjetjes së burtimeve për financimin e këtyre projekteve.

Mbështetja e vendimmarrjes përmes raportimit të rregullt dhe me kohë

Të raportohet në baza mujore për Kryetarin e Komunës. Raportet mujore të dorëzohen jo më larg se 7 ditë pune nga përfundimi i muajt.

Të raportohet në baza 6 mujore dhe vjetore për Kyetarin.

Të raportohet para Asamblesë Komunale në baza vjetore rreth implementimit të "Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2019-2023".

DREJTORATI I INSPEKTORIATIT

Me që Pandemia ende po vazhdon edhe këtë vit kalendarik neve na mbetet se si ta menaxhojmë në formën më të mirë të mundshme. Kjo formë e mbrojtjes do të bëhet edhe në formën tonë në bazë të rekomandimeve të OBSH si dhe Qeverisë së RKS. E jona është që ti harmonizojmë qëndrimet tona komunale me ato të Qeverisë.

Do ta përcjellim dhe sigurojmë:

Cilësin e ushqimit për konsum.

Do ta përcjellim çmimin e bukës dhe produkteve tjera ushqimore që mos të ketë ngritje çmimesh.

Do ta përcjellim kalibrimin e peshoreve si në qendra tregtare, supermarkete depo njashtu edhe fabrikave të millit dhe pompave me derivate të naftës.

Do ta luftojmë ekonominë jo formale.

Do ta ruajmë mjedisin me qëllim që të frymojmë lirshëm.

Në aspektin lokal mjedisore do të mundohemi që ndotësit e mdhej siç janë fabrikat e asfaltit, gurthyesit ti parandalojmë që të sillen komfort Ligjeve të mjedisit të sillen si biznese serioze në të kundërtën do ti marrim të gjitha masat ligjore deri në mbyllje.

Kujdes të veçantë do ti kushtojmë planit urban të qyteti me qëllim që ta mbrojmë planin rregullativ dhe mos të degradohet. Tani meqë kanë filluar operatorët e objekteve me banim kolektiv dhe afarizëm me kërkuar raportin final për tu pajisur me certifikat të përdorimit inspektor i ndërtimit do ta përgatit raportin final me kohë në bazë gjendjes faktike që e posedon.

Edhe inspektorët e trafikut do ti kushtojnë rëndësi jashtëzakonisht të madhe trafikut urbanë dhe autotaxive se a janë duke ju përmbajtur vendimeve të Qeverisë për periudhën e pandemisë. Kujdes të veçantë do ti kushtojmë edhe Aeroportit Ndërkombëtar "Adem Jashari" për ti përcjellur auto-taxit ilegale si dhe shitësit ambulantiv.

Do të përpiqemi maksimalisht ti ruajmë tokat bujqësore nga degradimi për qëllime tjera biznesore. Inspektor i bujqësisë do ti përndjekë ku edhe do ti marrë të gjitha masat ligjore ndaj tyre.

Një inspektim do ta bëjmë edhe në barnatoret bujqësore ku do ti verifikojmë herbicidete, pesticidet, plehun ku do ti verifikojmë deklaracionin e në veçanti afatin dhe prejarhjen e tyre.

Do ti koordinojmë punët edhe me drejtoratet tjera që të jemi sa ma unik dhe transparent para qytetarëve. Në shenjë bashkëpunimi dhe në bazë të obligimeve që kemi ndaj drejtorisë së shëndetësisë do ta përcjellim edhe orarin e kujdestarisë së barnatoreve shëndetësore humane me qëllim që qytetarët gjatë natës ta kanë të sigurt barnatoren për tu shërbyer edhe pas mesnatës.

DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Planifikimi vjetor është një udhërrëfyes i drejtimit të punës dhe angazhimeve në shëndetësi në Komunen e Lipjanit i cili është bazuar në legjislacionin në fuqi dhe strategjinë e DSHPS-së. Planifikimi i punës përbehet nga plani në trafshin e ofrimit

të shërbimeve shëndetësore, zhvillimin e vazhdueshëm profesional, programet e ngritjes profesionale dhe specializimet si dhe në ngritjen e infrastrukturës si me resurse humane po ashtu edhe me paisje mjekësore dhe infrastrukturë përcjellëse.

Plani në rrafshin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore:

Departamenti i Mjekësisë Familjare

Rritja e ciësisë në ofrimin e shërbimit profesional nga Mjeku Familjar në kuptimin e diagnostifikimit, ekzaminimit, trajtimit si dhe informimit dhe edukimit të pacientit për problemet shëndetësore.

Përdorimi i karteles shëndetësore domosdo të pacientët të cilët kanë kartela si dhe rritja e numrit të pacientëve me kartelë shëndetësore dhe regjistrimin në sistemin elektronik të SISH-it

Regionalizimi i pacientëve në për ordinance të caktuara ku do të marrin shërbime nga Mjeku Familjar.

Plotësimi si dhe krijimi i listës së pacientëve në secilen ordinance të Mjekut Familjar.

Zbatimi i njohurive të infermieres nga kursi i ngritjes profesionale për infermiere Familjare

Paisja me raftë adekuate për kartela shëndetësore.

Inventarizimi i ri i ordinanceve të Mjekësisë Familjare.

Vizita sistematike në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta.

Sektori i Vaksinimit dhe SISH-it

Furnizimi i mjaftueshëm me vakcina nga lista e vaksinimit për të gjithë fëmijët dhe të posalindurit.

Përfshirja me kohë dhe sipas orarit e të gjithë fëmijëve në vaksinim sipas kalendarit të vaksinimit në QKMF, QMF dhe AMF ku ka kuadër të përgaditur dhe të caktuar paraprakisht për vaksinim.

Realizimi i planit të vaksinimit të nxënësve në tërë Komunen e Lipjanit

Paisja me kompjuter të ri dhe UPES për punëtorët e SISH-it dhe rrejtit të internetit në të gjitha punktet shëndetësore

Grumbullimi me kohë i listave të sëmundjeve ngjyëse dhe raporteve si dhe futja e të gjitha të dhënave për SISH-in me kohë korrektësi dhe profesionalizem.

Inventarizimi me paisje informative sipas projektit të MSH-së për të gjitha objektet e QKMF QMF dhe AMF-të.

Sektori i Stomatologjisë

Vazhdimi i rritjes së shërbimeve të shëndetit oral, punimi i protezave të dhëmbëve, etj.

Servisimi me kohë dhe mirëmbajtja e paisjeve egzistuese ne këtë shërbim

Përfshirja e këtijë kuadri në ZHVP.

Furnizimi më i mirë me material stomatologjik

Riorganizimi në punë dhe vazhdimi i punës së ordinancave stomatologjike në QMF-të.

Sektori i Pulmologjisë

Furnizimi i mjaftueshëm dhe me kohë me barna antituberkulare

Furnizimi i mjaftueshëm me filma të rentgenit dhe pako për të sëmuret.

Organizimi i Ligjëratave në komunitet dhe Shkolla për semundjen e TBC pasi që në Komunen tone kemi rritje të semurve nga kjo semundje.

Sektori i Ginekologjisë dhe Maternitetit

Riorganizimi me staf,

Vazhdimi i funksionimit të këshillimores pran këtij shërbimi dhe aplikimi i vizitave shtëpiake,

Rritjen e cilësisë së shërbimeve si në diagnostikim po ashtu edhe në trajtimin e tyre,

Kthimi i besimit të nënave të reja për të kryer lindjet në këtë institucion pasi numri i lindjeve është ende shumë i vogël

Sektori i shërbimit të Emergjencës

Furnizimi i mjaftueshëm me barna,

Furnizimi me uniforma adekuate i gjithë stafit me uniforma sipas sezonit,

Vazhdimi me trajnime për shërbimin e emergjencës si të mjekëve po ashtu edhe të stafit të mesëm.

Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e paisjeve egzistuese si dhe furnizimi me paisje tjera të nevojshme për kryerjen e shërbimeve urgjente dhe emergjente.

Plotësimi me autoambulanca të reja me paisje të plota mobile për keto shërbime emergjente.

Trajnimi i vozitësve për shërbimin përkatës, në vozitje të shpejtë dhe përdorimi i drejtë i radiolodhjeve.

Paisja me radiolodhje në secilën autoambulancë dhe bazë, si hallkë kyçe e funksionimit të këtij shërbimi.

Sektori i Mirëmbajtjes

Vazhdimi i nivelit të punës në sektorin e mirëmbajtjes,

Rritja e nivelit të pastërtisë në secilin institucion dhe shërbim,

Furnizimi me kohë me lëndë djegëse për ngrohje,

Rritja e efikasitetit në evitimin e problemeve në infrastrukturën e institucioneve.

Furnizimi të mjaftueshëm me material higjienik dhe sanitar.

Të detajuar keni të bashkangjitur edhe planifikimet për renovimin e objektit të stomatologjisë, objektit e maternitetit-ginekologjisë, Renovimin e zyrave dhe ordinancave brenda objektit të QKMF-së, plani për renovimin komplet të pullazit të QKMF-së, Planin për rrethoj të AMF-Dobraj dhe hapja e një pusi për nevoja të AMF-së, Planin për renovimin e AMF-Banullë,

Plani për renovimin e AMF-Babush, Planin për renovimet në Janjevë, Plani për meremetime në shërbimin e emergjencës, Vendosja e perdeve në të gjitha hapësirat ku mungojnë ato.

Nga këto investime kapitale me prioritet i kemi këto investime:

Renovimi i objektit të shërbimit të stomatologjisë,

Heqja e shtëpizës nga duri ku është i vendosur OJQ, kryqi i kuq", dhe hapja e një pusi për nevoja të QKMF-së, dhe rregullimi i një shatërvani me ulëse për pushimin e pacientëve dhe qytetarëve.

Zëvendësimi i kupëzave me asfalt nga hyrja e katërt e QKMF-së deri të shërbimi i maternitetit, Renovimi i objektit të shërbimit të maternitetit,

Furnizimi me pajisje mjekësore dhe autoambulanca për nevoja të QKMF-së.

Sektor i Diagnostikues Laboratori dhe Rëntgeni:

Furnizimi me material të mjaftueshëm dhe cilësor,

Organizimi më efikas i zingjirit të punës, si dhe ambientit punues, Pajisja me aparaturë të re në kabinetin e Rentgenit.

Trajnime të vazhdueshme për stafin e këtijë sektori.

Fillimi i shërbimit të ECHO- ekzaminimeve me aparat të ri (ECHO e gjirit dhe gjendurave tiroide). Vazhdimi i punës me ECHO nga mjeku familjarë

Barnatorja Qendrore

Planifikimin me kohë dhe korrekt si dhe furnizimi me barna esenciale për komunen tonë, Furnizimi i rregullt i punkteve me barna nga lista esenciale si dhe ato komerciale.

Evidentimi i sakt i stokeve dhe nevojave të qendres dhe punkteve shëndetësore.

Raportimi i rregullt për sasin dhe gjendjen me furnizim me barna menagjerit me të lartë, Mbatja e rregullt e evidences së pacinteëve me sëmundje si diabeti, epi etj.

Rivendosja e Barnatores dhe depoz në katin e parë dhe me hyrje të veçantë.

Departamenti i Administratës

Sektor i administratës dhe personelit

Finalizimi i programit të MSH për evidentimin e punëtorve shëndetësor, Kryerja me kohë e lëndëve juridike, aktivendimeve, vendimeve etj.

Finalizimi sistemit me të avancuar në funksionin e arkivës në QKMF,

PLANI I PUNËS SË KRYETARIT DHE DREJTORATEVE KOMUNALE 2021

Sektor i për Ekonomi dhe Financa

Planifikimi dhe pagesa me kohë e kujdestarive dhe festave,
Transparenca nga shefi i këtijë sektori të menagjeri i tijë,
Ritja e të hyrave vetanake nga participimi në bashkëpagesa për shërbime shëndetësore,
Ritja e monitorimit të punëtorëve në evidentimin dhe kryerjen e pagesave.

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Bazuar në detyrat dhe obligimet e punës në kuadër të Drejtoratit, dokumenteve mbështetëse PZHK, Korniza buxhetore Parashikimi i të hyrave të tërësishme buxhetore Komunale, si dhe zhvillimet aktuale rreth planifikimit dhe implementimit të projekteve të interesit publik të Komunës, me qëllim të arrijës së objektivave të përcaktuara duke pasqyruar fushën e planifikimit dhe ndërtimit, është hartuar Plani i Punës së DPUM për vitin 2021, që rezultojnë në objektivat si:

- Ngritja e kapaciteteve me qëllim të ofrimit të shërbimeve profesionale dhe efektive sipas kërkesave të qytetarëve dhe në harmoni me rregullativën ligjore nga fusha e planifikimit dhe ndërtimit,
- Hartimi dhe zbatimi i i dokumenteve planore për projektet e planifikuara për vitin 2021,
- Ngritja e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies në cilësinë e shërbimeve
- Senzibilizimi i qytetarëve në mbrojtjen e mjedisit

QËLLIMET SPECIFIKE-OBJEKTIVAT	DETYRAT/ AKTIVITETET
Çka dëshirojmë të arrijmë	Si do të arrijmë qëllimet specifike?
B	Cilat detyra specifike /aktivitete duhet të ndërmerrem?
	C
I.Ngritja e kapaciteteve me qëllim të ofrimit të shërbimeve profesionale dhe efektive sipas kërkesave të qytetarëve dhe në harmoni me	Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të palëve. Realizimi i detyrave dhe obligimeve të parapara sipas përshkrimit të detyrave të punës. Përgjegjësi dhe efikasitet në nivel më të lartë

rregullativën ligjore nga fusha e planifikimit dhe ndërtimit,	Harmonizimi i Planit të Punës me prioritetet –Vendimet nga KK
	Trajtimi i ndërtimeve pa leje
II.Hartimi i dokumenteve planore, projektet dhe programet per zhvillim te qendrueshem	Hartimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis
	Miratimi i Planit për vendosjen e objekteve të përkohshme
	Programi 3 vjeçar i banimit
	Hartimi i HZK dhe VSM
	Sistemi i Adresave
	Krijimi i Regjistrit per NBB
III.Ngritja e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies në cilësinë e shërbimeve	Pergaditja e dokumenteve përfaqen zyrtare te komunës –publikimi
	Azhurimi i web-site te DPUMM – Komunes
	Sistemi i menaxhimit te shërbimeve te performances komunale
	Taksat dhe tarifat per Leje Ndertimi
	Seminare, trajnime
	KALENDARI I FESTAVE
Senzibilizimi i qytetarëve në mbrojtjen e mjedisit	Dita Ndërkombëtare e lligatave
	Dita Evropiane e Parqeve
	Dita Ndërkombëtare e Tokës
	Dita Ndërkombëtare e Ndryshimeve klimatike
	Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit
	Dita Boterore e Mjedisit
	Dita Evropiane e qyteteve pa makina
	Dita boterore e habitateve
	Dita nderkombetare e ecjes ne natyre
	Dita nderkombetare e Zonave Urbane

DREJTORATI PËR GJEODEZI DHE KADASTËR

Plani i punës së Drejtoratit për Gjeodezi dhe Kadastër për vitin 2021. Ndër objektivat kryesore të Drejtoratit për Gjeodezi dhe Kadastër për vitin 2021 janë:

Vazhdimi i digitalizimit të shërbimeve të gjeodezisë dhe lidhja e drejtpërdrejt me sistemin e të dhënave me Agjencionin Kadastral të Kosovës (AKK), përkatësishtë barja e të dhënave grafike nga Zyra Komunale Kadastrale (ZKK) në Lipjan dhe lidhja e drejtpërdrejt me AKK në Prishtinë.

Vazhdimi i azhurimit me softverin e avancuar për azhurnimin e të dhënave grafike "CAD MAP".

Për t'i realizuar objektivat, Drejtorati planifikon këto aktivitete:

Dhënie e propozimeve për gjeneralizim që duhet t'i përmblajë programi "CAD MAP".

Dalje në terren të gjeodetëve dhe azhuret i stafit të kadastrit, duke respektuar afatet e përcaktuar me ligje, për kërkesat dhe punët komunale për realizimin e projekteve të ndryshme dhe me kërkesë të institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë.

Bashkëpunimi me Zyrat e licencuara të gjeodetëve, rreth lëndëve të dorzuara për azhurim, nga këto zyra.

Rezultatet e pritura

Rezultatet e pritura konsistojnë në atë, si vijon:

Shërbime të plota profesionale sipas kërkesave të qytetarëve dhe zgjidhjen e këtyre kërkesave duke kombinuar aktivitetet në zyrë dhe teren.

Dhënia e sygjërimeve për lëndët, të cilat vijnë nga Zyrat e licencuara, si dhe bashkëpunimi me ato zyra të gjeodetëve të licencuar

DREJTORATI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Aktivitetet e përgjithshme vjetore të DSHP-së

Pranimi i kërkesave nga komuniteti, institucionet, subjektet etj. shqyrtimi i tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi si dhe përcjellja (arkivimi) i tyre,

Mbikëqyrja e kompanisë për pastrimin e rrugëve nga bora dhe akulli si dhe larjen e tyre gjatë sezonës verore,

Mbikëqyrja e kompanisë për mirëmbajtjen e ndriçimit publik,

Mbikëqyrja e kompanisë për mirëmbajtjen e hapësirave publike (Parqet, parkingjet) dhe hapësirat tjera në qytetin e Lipjanit.

Mbikëqyrja e kompanisë për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve,

Mbikëqyrja e kompanisë për sinjalizimin horizontal dhe vertikal në Komunën e Lipjanit,

Mbikëqyrja e kompanisë për mirëmbajtjen e varrëzave,

Mbikëqyrja e kompanisë për mirëmbajtjen e infrastrukturës në Komunën e Lipjanit,

Mbikëqyrja e kompanisë për mirëmbajtjen e shtigjeve të ecjes për këmbësorë dhe shtigjeve të biçikletave në Lipjan.

Mirëmbajtja dhe pastrimi i lumenjve në Komunën e Lipjanit.

Bashkëpunimi me Ministrinë e Infrastrukturës, Ministrinë e Pushtetit Lokal, Departamentet për Shërbime Publike të Komunave tjera dhe zbatimin i ligjeve të nxjerra nga Kuvendi i Kosovës dhe instruksionet e aprovuara nga Ministritë përkatëse që kanë të bëjnë me Shërbime Publike.

Bashkëpunimi me ndërmarrjet që kryejnë shërbime publike (Aerporti, PTK-në, KEDS-in, Ndërmarrjet Regjionale të Ujësjellësit dhe Menaxhimit të Mbeturinave, Ndërmarrjet Private të Transportit të udhëtarëve, Ndërmarrjet tjera që do të kryejnë shërbime publike në Komunën e Lipjanit).

Realizimi i të hyrave nga shfrytëzimi i përkohshëm i hapësirave publike,

Inicimi i procedurave të prokurimit për realizimin e projekteve kapitale të planifikuara për vitin 2021 sipas planit të prokurimit,

Kërkesa Sektorit pronësoreshë juridik dhe DGJK –së për definimin e pronës dhe caktimin e pikave gjeodezike,

Kërkesa DPUMM-së për hartimin e projekteve detale,

Kërkesa DBF-së për zotim të mjeteve financiare për implementimin e projekteve kapitale dhe kategoritë tjera, Kërkesë Drejtoratit për Inspektorat për inspektim bizneseve të cilët shfrytëzojnë hapësirën publike dhe kërkesë për inspektim në tregje ditëve kur mbahen tregjet,

Përgatitja e paramasave dhe paralogarive sipas kërkesave të institucioneve dhe palëve.

Është planifikuar minja, plehërimi i sipërfaqeve dhe mbjellja e gjelbërimit të ultë - barit, sipas kontratës së lidhur me operatorin ekonomik për mirëmbajtjen e parqeve dhe parkingjeve, Krasitja e drurëve dekorues dhe drunjtë për gjatë trotuareve të qytetit, Mbjellja e luleve në parqe, rrethrotullimet e qytetit dhe vazot për gjatë rrugëve si dhe në shesh, Pastroimi i sipërfaqeve gjelbëruese për gjatë rrugëve të qytetit, Rishikimi i mjeteve të shpenzuara dhe propozimi për ridentimin e mjeteve në gjashtëmujorin e dytë, Përkujdesja në realizimin e prioriteteve të projekteve në infrastrukturë publike dhe trafik, Përgatitjen për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve, trotuareve dhe hapësirave tjera publike në qytetin e Lipjanit, Përgatitjen e vazhdimi të pagesave për shfrytëzim të parkingjeve për Auto Taksi, Vazhdimi i dhënies së lejeve për shfrytëzim të hapësirave publike, Menaxhimi i projekteve kapitale, të cilat janë të planifikuara në buxhetin komunal për vitin 2021, Menaxhimi i mjeteve financiare nga grandet qeveritare, Përgatitjen e raporteve për punët e përfunduara, sipas planeve dinamike të projekteve, Pagesat operatorëve sipas situacioneve të përfunduara të parapara në Kontrata të prokurimit, Inspektimi i punimeve në terren.

Periudha kohore nga janar – dhjetor 2021

Në periudhën kohore nga 01/01 deri me 31/12/2021, planifikojmë të bëjmë përgatitjen për iniciimin e procedurave të prokurimit si dhe realizimin e punimeve për investimet kapitale të harmonizuara me planin e prokurimit, projekte të cilat financohen nga grandet qeveritare dhe të hyrat vetanake, si:

Nr.	Infrastruktura Publike
1	Mirëmbajtja Investive e Ndriqimit Publik në Qytet dhe Fshatra
2	Mirëmbajtja dhe rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në qytet e fshatra
3	Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në qytetin e Lipjanit dhe fshatra
4	Asfaltimi i rrugicave në Konjuh dhe zhavorimi i rruges në Branesh
5	Asfaltimi i rrugicave në Bujari faza II
6	Asfaltimi i Rrugicave në Hallaq te Vogel, Rufc te Ri dhe Rufc te vjeter
7	Riasfaltimi i rruges Shen Flori dhe Skenderbeu- Lipjan

8	Asfaltim i rrugicave ne Medvec
9	Asfaltimi i rrugicave faza III në Gadime të Eperme dhe Gadme Ulet
10	Ndertimi i shetitorës të pishat në Gadime
11	Asfaltimi i rrugicave në Varigovc
12	Asfaltimi i rrugicave , trotuareve, ndriçimi publik i Bregu i Zi
13	Asfaltimi i rrugicave në Mirenë
14	Asfaltimi i rrugicave në Sllavi faza III
15	Asfaltimi i rrugicave në Jeten e Re (Topliqan i Ri) Faza II
16	Asfaltimi i rrugicave në Grackë të Vogel
17	Asfaltimi i rrugëve në Lipjan Faza III
18	Ndertimi i rruges Gryka e Shpëtimtë-Kroimir
19	Ndriçimi publik në Leletiq dhe Vershevc
20	Ndriçimi publik në Hallaq të Madh
21	Ndriçimi publik me Dobrajë e Vogel, Luga dhe Gllanic
22	Zgjerimi i ndriçimit publik ne Ribarë të Vogel
23	Ndertimi i kolektorit të ujerave të zeza Blinajë, Qylagë, Dobrajë e Madhe
24	Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit ne Gllavicë, Magure , Dobrajë
25	Ndertimi i shtratis të lumit në Bujari
26	Vazhdimi i ndertimit të sheshit Adem Jashari
27	Fasadimi, renovimi i objekteve shumë banesore Lipjan
28	Ndertimi i parqeve dhe rregullimi hapësirave publike

Përpos projekteve të përshkruara më lartë të cilat financohen nga granti qeveritar dhe të hyrat vetanake e të cilat janë me prioritet për vitin kalendarik 2021, në vazhdim paraqesim edhe projektet të cilat janë të kontraktuara:

Mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara,

Mirëmbajtja e shënjestërimit horizontal dhe vertikal të komunikacionit,

Mirëmbajtja e Hapësirave të hapura publike, parqeve dhe parkingjeve,

Menaxhimin e kontratës për Mirëmbajtje të tregjeve,
Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve në qytetin e Lipjanit dhe
Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në qytet dhe fshatra të Komunës së Lipjanit: Loti 1, Loti 2, Loti 3,
Mirëmbajtja Investive e Ndrëçimit Publik në Qytet dhe Fshatra,
Mirëmbajtja dhe rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në qytet e fshatra,
Ndërtimi i objektit të ri të administratës së Komunës Lipjan,
Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në qytetin e Lipjanit,
Asfaltimi i rrugës Shqipëria-Hajredin Bajrami.

Do të mbikëqyren edhe projektet e kontraktuara të cilat janë në bashkëfinancim me Ministrinë ose organizatat tjera:

Asfaltimi i rrugës "Sadik Shala",
Asfaltimi i rrugës Sllavi-Aklap,
Asfaltimi i rrugës së Shkupit dhe rrugës së lumit në Gadime të Ulët,
Asfaltimi i rrugës tranzit lagja e Aklapit që lidhet me rrugën rajonale Lipjan-Janjevë,
Asfaltimi i rrugës Llugë-Radevë.
Ndërtimi i shtigjeve të ecjes faza e II.

Drejtorati për Shërbime Publike përmes projekteve nga infrastruktura publike do të menaxhojë edhe projektet nga fusha e arsimit, kulturës, shëndetësisë dhe projekte tjera të planifikuara për vitin 2021.

Gjatë këtij viti DSHP ka planifikuar që të bëjë largimin dhe eliminimin e 140 deponive të egra ilegale në territorin e Komunës.

DREJTORATI I PROKURIMIT

Për realizimin e këtyre objektivave, lypset një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha Drejtoritë, nga të cilat duhet të inicohen procedurat e prokurimit, për të gjitha aktivitetet e planifikuara, sipas Planifikimit të Prokurimit për Vitin Fiskal 2021. Për implementimin me sukses të Planit të Punës për Vitin 2021, ate do ta paraqsim në dy shtylla:

Objektivat e Drejtorisë së Prokurimit dhe
Realizimi i sukseshëm i këtyre objektivave

Objektivat e Drejtorisë së Prokurimit

Realizimi i përpikët i aktiviteteve të prokurimit të parapara sipas Planifikimit të Prokurimit për Vitiin Fiskal 2021
Kërkesë për njësitë kërkuese për respektimin e Planifikimit të Prokurimit
Planifikimi dhe përfundimi me kohë i çdo projekti të nisur,
Definimi i sakt financiar i projekteve në zhvillim dhe zotimi i mjeteve për këto projekte,
Koordinimi i Departamentit të Prokurimit me Departamentin e Thesarit për evidentimin e sakt të borjeve,
Dhënjë me kohë e urdhërbljerjeve për projektet e përfunduara,
Funksionalizimi i databazës për blerje të imta,
Obligimi i Departamenteve përkatëse për dorëzimin me kohë të faturave në Drejtorinë e Prokurimit,
Atestet për punët e përfunduara për çdo projekt të pranuar teknikisht

Realizimi i sukseshëm i këtyre objektivave

Inicimi me kohë i procedurave të prokurimit nga njësitë kërkuese.

Për iniciimin e një procedure të prokurimit, njësitë kërkuese duhet të bashkangjesin paramasat dhe parallogaritë për atë aktivitet të prokurimit si dhe Deklaratën e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së fondëve.

Definimi i sakt i aktiviteteve të prokurimit duke bashkangjitur edhe Projektin për aktivitetin e caktuar.

Zbatimi i përpikët i Planit Dinamik të punimeve nga Operatorët Ekonomik të mbikqyrrur nga menaxherët e atyre projekteve.
Mbikqyrja e vazhdueshme e aktiviteteve të prokurimit nga menaxheri i projekti dhe njoftimi me kohë për zhvillimet në implementimin e ati projekti.

Drejtoria e Prokurimit, në vazhdimsi duhet të jetë në koordinim me të gjitha njësitë kërkuese e sidomos me Departamentin Thesarit për evidentimin e sakt të borjeve.

Dorëzimi me kohë i faturave nga OE dhe raporteve mbi aktivitetet e zhvilluara nga menaxherët e projekteve për ekzekutimin e pagesave për aktivitetet e kryera.

Për kryerjen e punimeve me kualitet të lartë, duhet të bëhen edhe atestet për ato punë të përfunduara dhe pranimit teknik i tyre nga komisioni përkatës për atë aktivitet.

Një nga detyrat permanente të Drejtorisë do të jetë transparencë në zbatimin e gjitha proceduarve sipas LPP-së, duke filluar nga:

- Proceduar e hapur dhe e kufizuar
 - Procedura konkurruese me negociata
 - Procedura Konkurse të projektimit
 - Procedura e kuotimit të çmimeve, dhe
 - Procedura e prokurimit në vlera minimale.
- Varësisht nga aplikimi i cilësdo nga këto procedura, në rastet kur kjo parashihet me Ligj, Drejtoria do të zbatohet dispozitat ligjore, konform LPP-së.

Edhe gjatë viti fiskal 2021, detyrë parësore e Drejtorisë, do të jetë ulja e kostos së shpenzimeve për gjitha llojet e shpenzimeve, realizimi me kohë dhe në mënyrë cilësore i gjitha kërkesave të njësive shpenzuese, si dhe identifikimi real dhe vlerësimi i nevojave, në bashkëpunim të ndërsjellët me shfrytëzuesit e gjitha shtyllave të buxherit, si dhe përgatitja e planifikimit preliminar për gjitha llojet e prokurimeve për vitin e ardhshëm fiskal 2022.

DREJTORATI PËR BUIQËSI DHE PYLLTARI

OBJEKTIVAT

- Vazhdimi i përkrahjes për zhvillimin e bujqësisë dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese, përpunuese.
- Bashkëpunimi me Organizata të ndryshme, përmes bashkëfinancimit
- Avansimi i bujqësisë përmes tërheqjes së investitorëve.
- Bashkëpunimi me Agjensionin e Pyjeve të Kosovës për pyllzim, ripyllzim, rralim, ruajtjen e florës dhe faunës.
- Punësimi, ngritja profesionale dhe mirëqenia ekonomike e fermerve përmes subvencioneve dhe shërbimeve këshillimore.
- Zbatimi i projekteve për këshilldhënie në bashkëpunim me Shërbimet Këshillimore të MBPZHR-së dhe Fakultetit të Bujqësisë.
- Vizita dhe bashkëpunim me Drejtoritë e Bujqësisë dhe Pylltarisë në komuna tjera të Kosovës.

Organizimi i takimeve me fermerë me qëllim të informimit për rëndësinë dhe përfitimet që mundë ti kenë nga kultivimi i bimëve mjeksore dhe aromatike.

Mbajta e panairit me karakter promovues të prodhimeve bujqësore.

Trajtimi i rasteve specifike të qenëve endacak.

Aktivitetet:

Drejtorati i Bujqësisë dhe Pylltarisë vazhdon ti ndihmoj familjet që merren me bujqësi në komunën e Lipjanit, edhe këtë vit do ti ndihmojmë përmes subvencioneve dhe shërbime këshillimore.

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është që të përkrahim bujqësinë (fermerët) në komunën tonë.

Qëllimi i bashkëpunimit me Agjensionin Pyjor të Kosovës të bëhet përdorimi dhe ripërdorimi i sipërfaqeve të zhveshura, që do të ndikonte në mbrojtjen e tokave nga erozioni, poashtu edhe rritja e llogaridhënjes nga rojet e pyjeve dhe shtrëngimi me sanksione i dëmtuesve të pyllit.

Qëllimi i tërheqjes së investitorëve që të zhvillohet bujqësia, rritja e mirqenjes së fermerëve e me këtë edhe modernizimi i agroteknikës.

Komunikimi i vazhdueshëm me fermer mbetet ndër aktivitetet kryesore, sepse dhënja e këshillave fermerëve është po aq i rëndësishëm sa edhe subvencionimi.

Qëllimi i kështre vizitave bëhet me qëllim të shkëmbimit të përvojave profesionale.

Qëllimi i kështre kontakteve që t'i dalim në përkrahje fermerëve duke futur në prodhim kultura që japin sasi, cilësi dhe rritin mirëqenjen e fermerëve.

Qëllimi i këtij panairi është promovimi i produkteve bujqësore lokale dhe artizanate të ndryshme, si dhe pjesëmarrja e komunave fqinje.

Trajtimi i qenëve endacakë që mund të jenë bartës të ndonjë smundje, lehtë të transmetueshme tek njeriu apo që paraqesin ndonjë rrezikshmëri të lartë për njeriun.

DREJTORATI PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

PLANI VJETOR I PUNËS SË DMSH / NJPZSH PËR VITIN 2021.

Nr	Objektivat-Aktiviteti-Detyra	Bartësi i aktivitetit	Bashkëpunëtorët
1	Studimi-implementimi i strategjisë dhe Planit të veprimit për parandalimin e EDhRSHt dhe Strategjive tjera të sigurisë të nxjerra nga QRK, MPB...	Kryesuesi i KKSb, Koordinatori, KKSb, K-danti i stacionit policor Lipjan	MPB, -DSP dhe të involvarit sipas Strategjisë...
2	Hartimi i Planit Vjetor të veprimit të KKSb për vitin 2021	Koordinatori i KKSb	Kryetari i komunës, anëtarët e KKSb,
3	Hartimi i planit të trajnimeve të zjarfikësve dhe stafit tjetër të NJPZsh për vitin 2021	Komandanti i NJPZsh	Drejtori i DMSH
4	Kompletimi i të dhënave zyrtare prej drejtorive komunale dhe shënimeve nga terreni për hartimin e Vlerësimit të rrezikut për komunën e Lipjanit	Zyrtari i planifikimit	Drejtori dhe drejtoritë përkatëse
5	Krijimi i një baze të të dhënave për subjektet afariste nga lëmia e ndërtimit etj. Të cilat mund të angazhohen në tejkalimin e ndonjë emergjence madhore	Zyrtari i planifikimit në DMSH	Drejtori i DMSH, DSHP,
6	Hartimi i " Vlerësimit të rrezikut për komunën e Lipjanit" dhe aprovimi nga KD dhe KK si dokument zyrtar	Zyrtari për planifikim	Stafi i DMSH dhe subjektet e involvuara sipas Vendimit të kryetarit
7	Hartimi i dokumenteve të Planit për Mbrojtje dhe shpëtim sipas ligjit të dhënë në bazë të Vlerësimit.	Zyrtari për planifikim	

8	Azhurnimi i regjistrave të personelit të shtabeve lokale për reagim emergjent në raste të zjarreve apo fatkeqësive tjera	Zyrtari i planifikimit	Zyrtari për parandalimin e zjarreve
9	Implementimi i Planit të ligjëratave dhe trajnimeve që do të mbahen me nxënësit e shkollave për parandalimin e zjarreve fushore dhe malore	Komandanti i NJPZSh, Drejtoria e bujqësisë, Policia	Drejtoria e arsimit, Anëtar i EVSB, drejtorët e shkollave
10	Bashkëpunimi i rregullt me KKSb, EVSB, Policinë, FSK, KFOR- OSCE dhe organet e administratës komunale	Drejtori Komandanti i NJPZSh	Subjektet përkatëse
11	Mbajtja në gjendje të gatishmërisë së lartë e NJPZSh	K-danti i NJPZSh	DZSh /AME/MPB
12	Testimi i rregullt i sirenavë për alarmim publik të qytetarëve	DMSH	
13	Hartimi i procesverbaleve, raporteve, lejeve, pëlqimeve e dokumenteve tjera që kërkohen nga stafi DMSH.	Stafi i DMSH	Drejtoritë tjera
14	Detyrat tjera të cilat sipas ligjeve janë në kompetencë të DMSH NJPZSH dhe të cilat nuk mund të parashikohen	Stafi DMSH	Stafi i NJPZSH